

Broshurë teknike

ISOMAT AK-20

Kolë e cilësisë së lartë e modifikuar me polimerë dhe fleksibël për të gjitha llojet e pllakave dhe për vendosje me kërkesa të larta

Përshkrimi

ISOMAT AK-20 është një kolë për pllaka e cilësisë së lartë dhe fleksibël, me bazë çimentoje dhe e modifikuar me polimere. Ajo ofron një forcë ngjitesë fillestare dhe përfundimtare të lartë, si dhe rezistencë ndaj lagështirës dhe fleksibilitet. Ajo klasifikohet si absolutisht pa rrëshqitje (asnjë rrëshqitje e pllakës) dhe ka kohë të mëdha për mbajtjen hapur.

Ajo klasifikohet si kolë e llojit C2 TE S1 sipas standardit EN 12004.

ISOMAT AK-20 ka përfituar një Deklaratë Produkti Mjedisor (EPD) në vijim të një vlerësimi të impaktit mjedisor të ciklit të tij të jetës. Numri i regjistrimit: S-P-06170, The International EPD® System.

Fushat e përdorimit

ISOMAT AK-20 është e përshtatshme për ngjitjen e pllakave me thithshmëri ose pa thithshmëri (p.sh. pllakat "grës porcellanato"), gurit natyral, tullave dekorative, pllakat e mëdha etj. në mure ose dysheme, mbi sipërfaqe të ndryshme, dhe në veçanti aty ku kërkohet forcë ngjitesë e madhe, fleksibilitet dhe rezistencë e lartë ndaj lagështirës (p.sh. shtresat e vjetra të pllakave, dyshemetë me ngrohje nga poshtë, pllakat e gipsit etj.). E përshtatshme për përdorim në mjedise të brendshme ose të jashtme.

Të dhënat teknike

Trajta:	llaç çimentoje
Ngjyrat:	gri, e bardhë
Uji që nevojitet:	7,50-8,00 l për një thes 25 kg
Temperatura e përdorimit:	nga +5°C deri në +35°C
Trashësia e përdorimit:	deri në 15 mm
Koha e punueshmërisë:	të paktën 6 orë
Koha e mbajtjes hapur:	të paktën 30 minuta
Koha e mbajtjes hapur për riparime të vogla:	të paktën 30 minuta
Rrëshqitja:	≤ 0,5 mm
Stukimi i fugave në mure:	pas 3-8 orësh

Stukimi i fugave në dysheme: pas 24 orësh

Forca ngjitesë pas:

- 28 ditësh: $\geq 1,80 \text{ N/mm}^2$
- ngrohjes në +70°C: $\geq 1,60 \text{ N/mm}^2$
- zhytjes në ujë: $\geq 1,30 \text{ N/mm}^2$
- 25 ciklesh ngrirje-shkrirje: $\geq 1,40 \text{ N/mm}^2$

Rezistenca ndaj temperaturave: nga -30°C deri në +90°C

Aftësia e deformimit sipas standardit EN 12004-2: > 2,5 mm

Të gjitha matjet janë kryer sipas standardit EN 12004-2.

Udhëzimet e përdorimit

1. Nënshtrësia

Sipërfaqja që do të mbulohet duhet të jetë e pastër, pa pluhur, graso, bojë, materiale të lira etj. Rekomandohet njomja e sipërfaqes përpara përdorimit.

2. Përdorimi

ISOMAT AK-20 hidhet gradualisht në ujë duke u trazuar vazhdimisht, derisa të krijohet një masë uniforme në trajtë brumi. Për përzierjen rekomandohet përdorimi i një mikseri me xhiro të ulëta. Përzierja duhet të lihet rreth 5 minuta të stabilizohet dhe pastaj duhet të trazohet përsëri me ngadalë. Kola e pllakave duhet të shpërndahe ("e krehur") mbi sipërfaqe duke përdorur një mallë të dhëmbëzuar (krehër), me qëllim që të aplikohet në mënyrë uniforme në të gjithë sipërfaqen. Plakat duhet të fiksohen duke u ngjeshur në pozicionin e dëshiruar. Përzierja e përdorur duhet të mbulohet me pllaka brenda 30 minutash me qëllim që të evitohet formimi i "cipës", d.m.th. përpara se shtresa e ngjitesës të fillojë të mpikset.

Konsumi

1,5-4,0 kg/m², në varësi të madhësisë së dhëmbëve të mallës dhe të natyrës së nënshtrësës.

ISOMAT AK-20

Ambalazhimi

ISOMAT AK-20 ofrohet në thasë letre 15 dhe 25 kg dhe në qese plastike 5 kg.

Magazinimi

- Thasë letre 15 dhe 25 kg:
12 muaj nga data e prodhimit
- Thasë plastike 5 kg:
18 muaj nga data e prodhimit

Gjithë të mësipërmet janë në efekt me kusht që produktet të magazinohen në paketimi origjinal i pa hapur, në ambiente të mbrojtura nga lagështia dhe ngrica.

Shënime

- ISOMAT AK-20 përmban çimento dhe reagon si alkaline me ujin, kështu që klasifikohet si irritues.
- Sipërfaqet shumë poroze, si p.sh betoni i lehtë, pllakat e gipsit, pllakat e zdrukthit etj. duhet të lyhen fillimisht me astarin akrilik UNI-PRIMER.
- Shikoni reziqet e përdorimit dhe këshillat për sigurinë që janë të shkruara mbi thes.

ISOMAT AK-20 GRĪ



ISOMAT S.A.

17th km Thessaloniki – Ag. Athanasios
P.O. BOX 1043, 570 03 Ag Athanasios, Greece

08

EN 12004:2007+A1:2012


DoP No.: ISOMAT AK-20 GREY/1003-02
NB: 2032

Improved deformable cementitious adhesive with reduced slip and extended open time, for internal and external tiling.

Reaction to fire	Class E
Release of dangerous substances	See MSDS
Bond strength, as:	
- initial tensile adhesion strength	≥ 1 N/mm ²
Durability, for	
- tensile adhesion strength after heat ageing	≥ 1 N/mm ²
- tensile adhesion strength after water immersion	≥ 1 N/mm ²
- tensile adhesion strength after freeze thaw cycles	≥ 1 N/mm ²

ISOMAT AK-20

ISOMAT AK-20 E BARDHË

	
ISOMAT S.A. 17 th km Thessaloniki – Ag. Athanasios P.O. BOX 1043, 570 03 Ag Athanasios, Greece 08	
EN 12004:2007+A1:2012 DoP No.: ISOMAT AK-20 WHITE/1004-02 NB: 2032 Improved deformable cementitious adhesive with reduced slip and extended open time, for internal and external tiling.	
Reaction to fire	Class E
Release of dangerous substances	See MSDS
Bond strength, as:	
- initial tensile adhesion strength	≥ 1 N/mm ²
Durability, for	
- tensile adhesion strength after heat ageing	≥ 1 N/mm ²
- tensile adhesion strength after water immersion	≥ 1 N/mm ²
- tensile adhesion strength after freeze thaw cycles	≥ 1 N/mm ²

ISOMAT S.A.

BUILDING CHEMICALS AND MORTARS

ZYRAT QENDRORE – FABRIKA:

Kilometri i 17të i Autostradës Selanik-Aj. Athanasiu 570 03

Tel. : +30 2310 576 002, Fax: +30 2310 576 029

www.isomat.al e-mail: support@isomat.eu